



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Fuqizohemi së bashku...

Prill – Maj – Qershor 2019

AMSHC ➤ Ditar 22

Datë: 12.7.2019

NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

Faqe


Mbyllet faza e aplikimeve për shprehje interesi në Thirrjen Nr. 12	2
AMSHC solidarizohet me nismën: "Dhurimi i gjakut – një akt human i cili shpëton jetë"	2
EU Policy HUB & Friedrich Ebert Stiftung Tirana: Tryezë e Rrumbullakët	3
Tryezë e Rrumbullakët: "Kontributi i Shoqërisë Civile në Procesin e Integritetit në BE"	3
Takim konsultues në kuadër të hartimit të raportit mbi zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit 1995 (Pekin +25)	4
AMSHC shpall thirrjen për propozim të kandidatëve anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)	5
IDM Albania / Forumi i Politikave "Evropianizimi përtej procesit"	6
Partners Albania prezanton gjetjet dhe rekomandimet paraprake të "Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Shoqërinë Civile 2018 – Raporti për Shqipërinë"	7
Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm organizoi Konferencën e Parë Kombëtare "Aktorët e Vijës së Parë në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm"	8
Mbyllet thirrja për propozim të kandidatëve anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)	9
Instituti për Studime Publike & Ligjore (IPLS) prezanton dokumentin metodologjik "Monitorimi i Integritetit Gjyqësor"	9
Konsultim publik mbi IPA Maqedoni e Veriut - Shqipëri 2014 – 2020	10

Mbyllet faza e aplikimeve për shprehje interesi në Thirrjen Nr. 12

28 shkurt – 1 prill 2019

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mbyll fazën e aplikimeve për projekt-propozime nga OJF-të në kuadër të Thirrjes Nr. 12.

Në këtë thirrje u paraqitën 161 projekt-propozime nga organizata të shoqërisë civile.



AMShC solidarizohet me nismën:

“Dhurimi i gjakut – një akt human i cili shpëton jetë”

Tiranë, 4 prill 2019

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) solidarizohet me nismën “Dhurimi i gjakut – një akt human i cili shpëton jetë”, ku përfaqësues të saj dhuruan gjak vullnetarisht.

Kjo nismë është ndërmarrë nga bashkëpunimi i Qendrës së Transfuzionit të Gjakut në Tiranë dhe Fondacionit Fundjavë Ndryshe dhe gjaku i dhuruar do të jetë ndihmë e shtuar për të sëmurët talasemikë.



Tryezë e Rrumbullakët: "Kontributi i Shoqërisë Civile në Procesin e Integritimit në BE"

Tiranë, 18 prill 2019



Përfaqësuese nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në tryezën e rrumbullakët "Kontributi i Shoqërisë Civile në Procesin e Integritimit në BE", të organizuar nga EU Policy HUB & Friedrich Ebert Stiftung Tirana, e cila u mbajt në ambientet e Hotel Rogner.

Ky aktivitet synon që një grup përfaqësuesish të shoqërisë civile të fushës së Integritimit në BE, ekspertëve si dhe akademikë të fushës, të diskutojnë sfidat, pengesat dhe zgjidhjet që lidhen me një rol më të fortë dhe më të angazhuar të Organizatave të Shoqërisë Civile

në proceset e bërjes së politikave dhe reformat përkatëse të nevojshme për të arritur anëtarësimin në BE.

Gjatë këtij takimi u prezantuan edhe gjetjet e studimit të Tom Moddenborg nga Universiteti i Leipzig-ut, i cili ofron një analizë të thelluar dhe një qasje të krahasueshme ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë lidhur me rolin e rëndësishëm që organizatat e shoqërisë civile kanë në procesin e konsultimeve të politikave të reja si dhe nga ana tjetër një mbikëqyrje e masave dhe reformave qeveritare.



Takim konsultues në kuadër të hartimit të raportit mbi zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit 1995 (Pekin +25)

Tiranë, 19 prill 2019



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në një takim konsultues në kuadër të hartimit të raportit mbi zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit 1995 (Pekin +25), të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), si autoriteti kryesor përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, në bashkëpërgjegjësi dhe konsultim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), ku të pranishëm ishin edhe nga grupet e interesit dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Në hartimin e këtij Raporti, MSHMS dhe MEPJ u mbështeten edhe në informacionet e kërkuara paraprakisht nga një pjesë e institucioneve të pavarura dhe organizatave të shoqërisë civile.

2020-ta përkon me një vit të rëndësishëm analize mbi hapat e hedhur në drejtim të barazisë gjinore dhe fuqizimit të të gjitha grave dhe vajzave, si dhe mbi zbatimin e angazhimeve të tjera globale, siç janë ato të Rezolutës 1325 (2000) të Këshillit të Sigurisë dhe rezolutat e mëvonshme për gratë, paqen dhe sigurinë; Axhendës së Veprimit të Adis Abebës në Konferencën e Tretë Ndërkombëtare mbi Financimin për Zhvillim (2015); Marrëveshjes së Parisit mbi ndryshimet klimatike (2015), etj.

Raportimi do të përqendrohet në arritjet dhe sfidat në të 12 fushat e përcaktuara në Platformë, konkretisht:

1. *Gratë dhe varfëria;*
2. *Arsimi dhe trajnimi i grave;*
3. *Gratë dhe shëndeti;*
4. *Dhuna ndaj grave;*
5. *Gratë dhe konfliktet e armatosura;*
6. *Gratë dhe ekonomia;*
7. *Gratë në politikë dhe vendimmarrje;*
8. *Mekanizmat institucionalë për përparimin e grave;*
9. *Të drejtat njerëzore të grave;*
10. *Gratë dhe media;*
11. *Gratë dhe mjedisi;*
12. *Fëmija vajzë.*

Kjo analizë po pasqyrohet sipas gjashtë grupimeve tematike, duke marrë në konsideratë dhe pyetjet orietuese për secilën, siç sugjerohet në udhëzimet përkatëse të UN Women dhe UNECE për këtë qëllim, respektivisht:

1. *Zhvillimi gjithëpërfshirës, prosperiteti i përbashkët dhe puna e denjë*
2. *Çrrënjësja e varfërisë, mbrojtja sociale dhe shërbimet e kujdesit shoqëror*
3. *Liria nga dhuna, stigma dhe stereotipet*
4. *Pjesëmarrja, llogaridhënia dhe institucione të përgjigjshme gjinore*
5. *Shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse*
6. *Ruajtja, mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit*



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

KËSHILLI KOMBËTAR
PËR SHOQËRINË CIVILE



AMShC shpall thirrjen për propozim të kandidatëve anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

22 prill 2019 – 20 maj 2019

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), shpall thirrjen për propozim të kandidatëve anëtarë të shoqërisë civile në KKShC, për 4 (katër) vendet vakante të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 1-vjeçare, përkatësisht:

- **1 (një) anëtar** për fushën e veprimit B:
“Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor”
- **3 (tre) anëtarë** për fushën e veprimit C:
“Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës”

Faza e procesit të Propozimit të Kandidatëve anëtarë të KKShC-së është e hapur **nga data 22 prill 2019 deri më 20 maj 2019, ora 16:30**, kohë në të cilën paraqiten kandidaturat dhe dokumentacionet mbështetëse si nga ana e organizatave propozuese të kandidatëve, ashtu edhe nga ana e të kandiduarve.

Për më shumë informacione vizitoni faqen

www.amshc.gov.al/kkshc

IDM Albania / Forumi i Politikave "Evropianizimi përtej procesit"

Tiranë, 23 prill 2019



Përfaqësuese nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në Forumin e Politikave: "Evropianizimi përtej procesit", i cili u organizua nga "Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim" dhe ku morën pjesë ekspertë shqiptarë si dhe përfaqësues të lartë nga think tank-e të njohura të BE-së: Qendra për Studime Politike Evropiane – CEPS Bruksel, Nisma për Stabilitetin Evropian – ESI Berlin, dhe Qendra e Politikave Evropiane – EPC Bruksel.



Qëllimi i Forumit të Politikave "Evropianizimi përtej procesit" është fillimi i një dimensionimi të ri të shkëmbimit të përvojave midis think tank-eve nëpërmjet një sërë debatesh të cilat sjellin njohuritë dhe këndvështrimet e organizatave studimore të njohura të BE-së.



Kjo nismë pritet të inkurajojë një proces mësimi për aktorët e interesuar në Shqipëri lidhur me një gamë të larmishme temash aktuale për BE-në, të tilla si; reformimi i BE-së, e ardhmja e Eurozonës, sundimi i ligjit dhe dobësimi i demokracisë, BREXIT, emigracioni, zgjedhjet evropiane, tregtia, roli i BE-së në botë dhe tema të tjera të lidhura me BE-në.

Në përfundim, procesi pritet të ofrojë një kuptueshmëri më të mirë të këtyre çështjeve, si dhe për mënyrën se si ato do të ndikojnë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe procesin e zgjerimit në vitet në vijim.

Partners Albania prezanton gjetjet dhe rekomandimet paraprake të “Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Shoqërinë Civile 2018 – Raporti për Shqipërinë”

Tiranë, 25 prill 2019



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në takim mbi prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve paraprake të “Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Shoqërinë Civile 2018 – Raporti për Shqipërinë”, i cili u organizua nga Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile.

Takimi shërbeu si një forum diskutimi i fokusuar në një analizë të ndryshimeve të ndodhura gjatë periudhës janar 2018 – shkurt 2019 mbi kuadrin ligjor dhe praktik që afekton sektorin, me prezencën e zj. Alketa Knuti - zv. Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve donatore në vend.

Disa nga çështjet kryesore në të cilat u fokusua diskutimi ishin:


- *Rishikimi i Ligjit Nr. 8788, datë 7/5/2001, “Për Organizatat Jo-fitimprurëse”, ku të shprehet qartë dallimi midis veprimtarisë ekonomike dhe aktivitetit jofitimprurës të OJF-së.*
- *Rishikimi i nenit 45 të Ligjit Nr. 97/2018, datë 03.12.2018 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar mbi “Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve”.*
- *Regjistri elektronik i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për OJF-të, nevoja për saktësime dhe unifikim të të dhënave për sektorin.*
- *Çregjistrimi nga TVSH për OJF-të që nuk deklarojnë për 12 periudha të njëpasnjëshme TVSH të pagueshme.*
- *Ligji 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe ndryshimet që parashikon lidhur me raportimin e OJF-ve dhe publikimin e pasqyrave financiare.*

Në takim u prezantua studimi i fundit i realizuar nga Partnerët Shqipëri mbi një nga metodat alternative të financimit në ditët e sotme siç është Crowdfunding. Crowdfunding është një nga metodat risi të ngritjes së fondeve, e cila po përdoret gjerësisht nga sektori dhe sipërmarrjet sociale në rajon dhe Evropë, por është pak e eksploruar në Shqipëri. Nëpërmjet këtij studimi synohet informimi dhe nxitja e sektorit rreth përdorimit të kësaj metode për të gjeneruar fonde.

Raporti i “Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Shoqërinë Civile – Raporti për Shqipërinë” dhe materiali hulumtues “Platformat Crowdfunding: Një Burim Alternativ Financimi” do të publikohen brenda muajit Maj 2019.

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Qendra CVE) organizoi Konferencën e Parë Kombëtare “Aktorët e Vijës së Parë në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm”

Tiranë, 30 prill 2019



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) morën pjesë në Konferencën e Parë Kombëtare “Aktorët e Vijës së Parë në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm”, të organizuar nga Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Qendra CVE), e cila u mbajt në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

Në këtë konferencë kombëtare, u bënë së bashku punonjësit e vijës së parë - mësues, punonjës social, oficerët e policimit në komunitet – si dhe përfaqësues të ministrive të linjës dhe të ftuar nga shoqëria civile, komunitetet fetare, media, dhe partnerë rajonalë e ndërkombëtarë.

Qëllimi kryesor i konferencës është prezantimi i rasteve konkrete dhe ndërhyrjeve në fushën e parandalimit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm të zbatuara nga aktorët e vijës së parë në të gjithë vendin.

Rastet e prezantuara gjatë konferencës: Arsimi; Mbrojtja Sociale; Policimi në Komunitet; Sistemi i Burgjeve; Qeverisja Vendore – nxitën diskutimin mbi rezultatet e arritura dhe krijimin e praktikave të mira për zbatimin e mëtejshëm të ndërhyrjeve në këtë fushë.

Mbyllet thirrja për propozim të kandidatëve anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

22 prill 2019 – 20 maj 2019

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), mbyll fazën e aplikimeve në kuadër të thirrjes për propozim të kandidatëve anëtarë të shoqërisë civile në KKShC, për 4 (katër) vendet vakante të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 1-vjeçare.

Gjatë gjatë kësaj faze u paraqitën 18 (tetëmbëdhjetë) kandidatura, përkatësisht:

- **7 (shtatë) kandidatura** për fushën e veprimit B:
“Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor”
- **11 (njëmbëdhjetë) kandidatura** për fushën e veprimit C:
“Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës”

Për më shumë informacione vizitoni faqen: www.amshc.gov.al/kkshc

Instituti për Studime Publike & Ligjore (IPLS) prezanton dokumentin metodologjik “Monitorimi i Integritetit Gjyqësor”

Tiranë, 24 maj 2019



Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Andi Kananaj mori pjesë në takim prezantues të dokumentit metodologjik “Monitorimi i Integritetit Gjyqësor”, i cili u organizua nga Instituti për Studime Publike & Ligjore (IPLS).

Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, që financohet nga Bashkimi

Evropian në partneritet me “Save the Children” dhe “Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara”.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm Ministri dhe Drejtësisë dhe Kryetarët e Qeverisjes së Gjyqësorit dhe Prokurorisë, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kryetari dhe Anëtarë të KED. IPLS ka draftuar Dokumentin metodologjik “Monitorimi i Integritetit Gjyqësor” dhe nëpërmjet këtij aktiviteti synon të prezantojë fushat kryesore të

performancës së aktiviteteve gjyqësore, me faktorët, që duhen konsideruar për monitorimin e integritetit gjyqësor.




Ky dokument synon të kontribuojë në forcimin dhe zhvillimin e integritetit gjyqësor sipas një metodologjie bashkëkohore, të elaboruar dhe pranuar gjerësisht nga standardet ndërkombëtare të promovimit të integritetit gjyqësor.



Me qëllimin për të ndihmuar aktorët e shoqërisë civile si watchdog të integritetit gjyqësor, Metodologjia e Integritetit Gjyqësor synon t'u shërbejë atyre në aktivitete monitoruese të ardhshme, por edhe gjykatave dhe gjyqtarëve në përpjekjet për rritjen e integritetit gjyqësor, gjatë punës së tyre, e për rrjedhojë dhe në rritjen e besimit të publikut tek drejtësia.

Konsultim publik mbi IPA Maqedoni e Veriut - Shqipëri 2014 – 2020

Korçë, 7 qershor 2019



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në një konsultim publik në kuadër të "Programit IPA Maqedoni e Veriut - Shqipëri 2014 - 2020", i cili u mbajt në qytetin e Korçës.

AMSHC ➤ Ditar 22

Prill – Maj – Qershor 2019

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adresa: Rruga "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 4 22 355 69

E-mail: info@amshc.gov.al Website: www.amshc.gov.al



Korrik – Gusht – Shtator 2019

AMSHC ➤ Ditar 23

Data: 9.10.2019

NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

Faqe

Open Day - Qendra e Shërbimeve PRO PAK	2
Hospices of Hope lançon zyrtarisht projektet e saj në Shqipëri.....	4
Shpallen listat emërore përfundimtare të kandidaturave të kualifikuara për t'u votuar për anëtarë nga shoqëria civile në KKShC	6
VOTIM ONLINE për zgjedhjen e anëtarëve të KKShC-së	6
AMSHC zhvillon takime prezantuese të masave kundër korrupsionit.....	7
Shpallen emrat e katër anëtarëve të rinj nga shoqëria civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile	8
Takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile	9
Aktiviteti "Fuqizimi i llogaridhënies, transparencës dhe qendrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile – Kodi i Standardeve për OShC-të"	10



Open Day - Qendra e Shërbimeve PRO PAK

Tiranë, 8 korrik 2019

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në ceremoninë e hapjes të Qendrës së Shërbimeve PRO PAK, të organizuar nga Fondacioni “Down Syndrome Albania” (DSA).



100 fëmijë me aftësi ndryshe dhe familjet e tyre në Shqipëri do të përfitojnë nga shërbimet në qendrën e sapo hapur të PRO PAK të menaxhuar nga Fondacioni “Down Syndrome Albania”. Të gjithë njerëzit me aftësi ndryshe kanë të drejtë të kenë qasje në të gjitha shërbimet publike, të kontribuojnë në komunitet dhe jetojnë një jetë me vlera.





Shërbimet kryesore të kësaj qendre:

1. Vlerësime nga ekipi multidisiplinar
2. Terapi fizike, psikomotricitet dhe hidroterapi
3. Terapi gjuhe dhe të foluri (logopedi)
4. Terapi zhvillimi dhe okupacionale
5. Terapi “Analiza e Aplikuar e Sjelljes” (ABA)
6. Terapi me metodën Floortime
7. Terapi Arti dhe Muzikoterapi
8. Terapi në grup
9. Shërbimi i ndërhyrjes së hershme terapeutike në mjedisin natyror të familjes
10. Shërbimi i mbështetjes në kopshte/ shkolla
11. Kursi i gjuhës dhe i matematikës
12. Kursi i kërcimit
13. Kursi i autonomisë personale për fëmijët 3- 13 vjeç
14. Kursi i autonomisë sociale për adoleshentë dhe të rritur
15. Këshillim psikologjik individual me prindërit
16. Terapi në grup me prindërit
17. Asistencë ligjore



Hospices of Hope lançon zyrtarisht projektet e saj në Shqipëri

Tiranë, 9 korrik 2019



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në një Garden Reception me rastin e lançimit zyrtar të projektit në Shqipëri, të Hospices of Hope, i cili u mbajt në Grand Hotel & Spa Tirana.

Në këtë aktivitet ishin të ftuar Ambasadori Britanik në Shqipëri; diplomatë nga misione të ndryshme ndërkombëtare si dhe përfaqësues biznesi vendor dhe ndërkombëtarë; përfaqësues të partnerëve të vendit Ryder Albania dhe ABC Center.

Hospices of Hope është një organizatë bamirësie ndërkombëtare e themeluar në Mbretërinë e Bashkuar që i dedikoi pothuajse tre dekadat e fundit zhvillimit të shërbimeve të kujdesit paliativ në Evropën Jug-Lindore. Kujdesi paliativ është një qasje që përmirëson cilësinë e jetës së pacientëve dhe familjeve të tyre që përballesh me problemin që shoqërohet me sëmundje të rrezikshme për jetën, përmes parandalimit dhe lehtësimit të vuajtjeve me anë të identifikimit të hershëm dhe vlerësimit të saktë dhe trajtimit të dhimbjes dhe problemeve të tjera, fizike, psiko-sociale dhe shpirtërore.





Misioni i Hospices of Hope në Shqipëri është të kontribuojë në zhvillimin e kujdesit paliativ brenda vendit dhe të rrisë hyrjen në këtë lloj shërbimesh për ata në nevojë. Për të përmbushur misionin e tij Hospices of Hope ka krijuar partneritete me organizatat vendore dhe po zbaton në mënyrë aktive katër projekte: Dy ekipe multidisiplinare të lëvizshme në Tiranë dhe Durrës me Ryder Albania; Një Qendër e Kujdesit Ditor Paliativ, e cila u zhvillua me Qendrën Shëndetësore ABC në Tiranë dhe një ekip të lëvizshëm për kujdes paliativ të integruar në Spitalin Rajonal të Kukësit.

Projekti mbulon shpenzimet e kujdesit, pagat, kostot administrative përfshirë transportin, trajnimet e kujdesit paliativ si dhe zhvillimin e një aplikacioni online për ofruesit e shërbimeve. Të gjitha shërbimet e ofruara në Rrjetin e Hospices of Hope janë falas për përfituesit.

Projektet e Hospices of Hope Albania janë zbatuar me mbështetjen financiare të Fondacionit Medicor dhe Fondacionit Bristol-Myers Squibb.



Shpallen listat emërore përfundimtare të kandidaturave të kualifikuara për t'u votuar për anëtarë nga shoqëria civile në KKShC


Tiranë, 23 korrik 2019

Në kuadër të zgjedhjeve për katër vendet vakante të anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 1-vjeçare, AMShC në rolin e Sekretariatit Teknik të KKShC-së, shpall 14 (katërbëdhjetë) kandidaturat e kualifikuara për t'u votuar, përkatësisht:

- **4 (katër) kandidatura për fushën e veprimit B.**
“Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor”
- **10 (dhjetë) kandidatura për fushën e veprimit C.**
“Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës”

24 – 31 korrik 2019

Në përfundim të procesit të hapur të votimit online,
i aksesueshëm në adresën www.amshc.gov.al/kkshc,
i cili zgjati për 8 ditë, rezultoi se votuan 425 votues.



TAKIME PREZANTUESE të masave kundër korrupsionit

Korrik – Gusht 2019

*Strategjia Ndërsektoriale
kundër Korrupsionit 2015-2020*

AMSHC zhvillon takime prezantuese të masave kundër korrupsionit

Korrik – Gusht 2019

Në kuadër të zbatimit të strategjisë kundër Korrupsionit, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) organizoi takime prezantuese të masave anti-korrupsion në disa qytete të vendit me përfaqësues të shoqërisë civile.

Këto masa organizohen në funksion të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, me qëllim ofrimin pranë aktorëve të shoqërisë civile obligimet e Institucionit të AMSHC-së në zbatimin e kësaj strategjie.

Përfaqësuesit e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) gjatë takimeve informuese bënë prezantimin e masave dhe të planit të veprimit anti-korrupsion në tërësi të zgjatur deri në vitin 2023 si dhe diskutuan dhe shkëmbyen mendime me pjesëmarrësit në formë bashkëbisedimi për ofrimin e sugjerimeve për realizimin sa më të suksesshëm të masave.

Takimet u zhvilluan në qytetet:

- **Vlorë:** 18 korrik 2019
- **Kukës:** 25 korrik 2019
- **Sarandë:** 1 – 2 gusht 2019
- **Korçë:** 8 gusht 2019
- **Berat:** 15 gusht 2018

Shpallen emrat e katër anëtarëve të rinj nga shoqëria civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile

Tiranë, 26 gusht 2019

Pas përfundimit të fazës së numërimit dhe rikonfirmimit të votës online, në kuadër të zgjedhjeve për katër vendet vakante të anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 1-vjeçare, Komisioni Teknik i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) pranë KKShC-së shpalli emrat e katër anëtarëve të rinj të zgjedhur nga procesi i votimit:

- **Për fushën e veprimit B.**

“Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor”

- 1. Shpëtim MYRTO**

Shoqata e Përdorimit të Pyjeve dhe Kullotave Komunare "DROJA-1", fshatrat Brret, Picrrage, Gjyraj-Krujë

- **Për fushën e veprimit C.**

“Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës”

- 1. Atrida FERKETI**

Gruaja në Integrim (GI)

- 2. Fabiola LAÇO – EGRO**

Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"

- 3. Indrit SEFERI**

Shoqata "MAYA" (Shoqata Rinore Mjekësore Shqiptare)

Gjithashtu, Komisioni Teknik i AMShC-së pranë KKShC-së bëri shpalljen dhe publikimin online në faqen zyrtare, rrjetet sociale dhe e-mail të “Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve Përfundimtare të Votimit” dhe “Listat emërore të kandidatëve të votuar me rezultatet përfundimtare të votimit”.

Për më shumë informacion, vizitoni linkun:
www.amshc.gov.al/kkshc

Takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Tiranë, 23 shtator 2019



Zhvillohet pranë zyrave të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) në orën 11:10 një takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC).

Pikat e agjendës së takimit:

- *Prezantimi i katër anëtarëve të rinj të zgjedhur;*
- *Monitorimi i zbatimit të “Udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023” të rishikuar të miratuar;*
- *Diskutim mbi organizimin e Konferencës së Parë Kombëtare të Shoqërisë Civile, ku të ballafaqohen përfaqësues të shoqërisë civile me përfaqësues të Qeverisë dhe komunitetit të donatorëve në lidhje me sfidat e këtij sektori;*
- *Diskutim mbi agjendën dhe organizimin e mbledhjes së Këshillit si dhe propozimi i caktimit të një date.*



Aktiviteti “Fuqizimi i llogaridhënies, transparencës dhe qendrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile – Kodi i Standardeve për OShC-të”

Tiranë, 26 shtator 2019



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në aktivitetin “People2People” me temë “Fuqizimi i llogaridhënies, transparencës dhe qendrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile – Kodi i Standardeve për OShC-të”, të organizuar nga “Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (NRC)” dhe “Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim”.

Merrnin pjesë rreth 55 përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile, agjenci ndërkombëtare dhe donator në Shqipëri, të cilët kanë kontribuar në zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile në Shqipëri dhe qëndrueshmërinë e tij.

Fokusi i aktivitetit ishte mundësia e krijimit të një mekanizmi vetë-rregullues dhe rritja e standardit të funksionimit të OShC-ve dhe transparenca e tyre.



AMSHC ➤ Ditar 23

Korrik – Gusht – Shtator 2019

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adresa: Rruga "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 4 22 355 69

E-mail: info@amshc.gov.al Website: www.amshc.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Fuqizohemi së bashku...

Tetor – Nëntor – Dhjetor 2019

AMSHC ➤ Ditar 24

Datë: 23.1.2020

NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

Faqe

Konferenca e dytë e Ballkanit Perëndimor – ReLOaD	2
Instituti i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit (CDI) organizon edicionin e 5^{-të} të Forumit të Lidhjes në Tiranë 2019 - "Weaving the fabric of the union"	4
Zhvillohet mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC).....	5
Vizitë studimore e OShC-ve pjesëmarrëse të Akademisë së OJF-ve	7
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) prezanton Indeks të Qëndrueshmërisë së OShC-ve: Raporti për Shqipërinë 2018	8
AMSHC mbështet nismën #ShqipëriaSolidare për situatën e krijuar nga goditja e tërmetit.....	9
"Kontribute vullnetare, Emergjencia" Numrat e llogarive në bankat e nivelit të dytë	10
Këshilla për prindërit në familje në rast tërmeti.....	11
Takime informuese dhe konsultimi mbi procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)	16
Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane (ISSH) prezanton studimin "Përshpejtim i zhvillimit dhe bashkëpunimit qytetar"	17



Konferenca e dytë e Ballkanit Perëndimor – ReLOaD

Tiranë, 8 – 9 tetor 2019



Përfaqësuese nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në Konferencën e dytë të Programit “ReLOaD” të Ballkanit Perëndimor “Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies drejt përmirësimit të demokracisë lokale në Ballkanin Perëndimor”, e cila u zhvillua në Tiranë gjatë datave 8 dhe 9 tetor 2019.



Në konferencë u prezantuan përvojat e bashkëpunimit midis autoriteteve lokale dhe shoqërisë civile në lidhje me transparencën e procedurave dhe qartësinë për financimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Fokus kryesor iu dha dallimeve dhe ngjashmërive legislative në të gjithë rajonin si dhe praktikat ekzistuese dhe përvojat e Bashkimit Evropian.





Eventi u nda në tri seanca plenare:

1. *Financimi transparent i OShC-ve dhe përfitimet e tij në një komunitet lokal - perspektivat e qeverive lokale*
2. *Financimi transparent i OShC-ve dhe përfitimet e tij në një komunitet lokal - perspektivat nga OShC-të si përfitues të grantit*
3. *Si të përmirësojmë pjesëmarrjen qytetare, aktivizmin dhe përfshirjen e të rinjve në komunitetet lokale - A mund ta bëjmë më mirë?*



Në konferencë morën pjesë më shumë se 120 përfaqësues të autoriteteve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia.



Instituti i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit (CDI) organizon edicionin e 5-të të Forumit të Lidhjes në Tiranë 2019 - "Weaving the fabric of the union"

Tiranë, 29 – 31 tetor 2019



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në edicionin e 5-të të Forumit të Lidhjes në Tiranë 2019 – “Weaving the fabric of the union”, i cili u mbajt në Hotel Rogner dhe u organizua nga Instituti i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit (CDI) në partneritet me Friedrich Ebert Stiftung–FES, Hanns Seidel Stiftung–HSS and Konrad Adenauer Stiftung–KAS; në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Bashkëpunimit Rinor-RYCO, dhe; me mbështetjen e Samitit të Ballkanit Perëndimor në Poznan dhe të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal-RCC.

Në këtë aktivitet morën pjesë ekspertë, studiues, akademikë, koordinatorë të shoqërisë civile, WBS dhe politikë-bërës të tjerë të përfshirë në Zgjerimin e BE-së në WB6, në bashkëpunimin rajonal dhe dinamikat e lidhjes.



Ky edicion i forumit analizoi përparimin e Agjendës së Lidhjes në transport dhe energji, si dhe lidhjes P2P, dhe më pas debatimin mbi rolin që kanë projektet e infrastrukturës së lidhjes në përmirësimin e qeverisjes institucionale të WB6, ankorimin e vendeve WB6 në rrugën e tyre në BE, si dhe ndihmën për reformat institucionale të angazhuara të BB6.

Programi ishte organizuar në gjashtë panele dhe projektuar për të mbuluar të dyja sektorin dhe dinamikat transversale:



- Më 30 tetor – “Gjendja e Lidhjes në WB6”, panelet mbuluan përbërësin hapësinor të Agjendës së Lidhjes në sektorët e energjisë dhe transportit, si dhe lidhjen P2P.
- Më 31 tetor – “Lidhja dhe konvergjenca”, lidhja në rajonin e WB6 është analizuar në kontekstin më të madh të dinamikës së integritimit në BE dhe reformave.



Zhvillohet mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Tiranë, 12 nëntor 2019



Mbahet mbledhja e radhës e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), e cila u organizua nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), pranë ambjenteve të Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD), në Kryeministri, ku kishte të ftuar organizata të shoqërisë civile.



Në këtë mbledhje u miratua Procesverbali i Mbledhjes së KKShC-së, të mbajtur më datë 22.6.2018; u diskutua mbi ndarjen e detyrimeve, ecurinë e KKShC-së në vazhdim dhe angazhimin e saj në monitorimin e VKM-së Nr. 539, datë 25.7.2019; Përfshirja e Shoqërisë Civile në Procesin e Negociatave; Organizimi i Konferencës së parë Kombëtare për Shoqërinë Civile; Ngritja e Grupit të Punës lidhur me Vullnetarizmin.

Vizitë studimore e OShC-ve pjesëmarrëse të Akademisë së OJF-ve

Tiranë, 21 nëntor 2019



Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në kuadër të Programit të Akademisë së OJF-ve për Organizatat e Shoqërisë Civile - nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, organizoi një takim pranë zyrave të institucionit me organizata të shoqërisë civile pjesëmarrëse të këtij programi.



Akademia është një program 9-mujor i dedikuar për Drejtues dhe Manaxherë të lartë të organizatave të shoqërisë civile, i cili synon rritjen e kapacitetit të tyre në manaxhimin organizativ dhe zhvillimin e qëndrueshëm të organizates.

Përfaqësuesit e AMSHC-së bënë një prezantim të shkurtër të rolit dhe veprimtarisë së institucionit, Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) dhe Udhërrëfyesin si edhe u diskutuan me të ftuarit mbi këto tema.



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) prezanton Indeks të Qëndrueshmërisë së OShC-ve: Raporti për Shqipërinë 2018

Tiranë, 22 nëntor 2019



Përfaqësuese nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në takim të prezantues të “Indeksit të USAID për Qëndrueshmërinë së OShC-ve: Raporti për Shqipërinë 2018”, të organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), i cili u mbajt pranë ambjenteve të Hotel Tirana International.

Në këtë panel diskutimi morën pjesëmarrës nga shoqëria civile, komuniteti i donatorëve, aktorët shtetërorë dhe pjesëmarrës nga media, të cilët së bashku diskutuan tendencat në qëndrueshmërinë e sektorit.

Qëndrueshmëria e përgjithshme e sektorit të shoqërisë civile nuk pësoi ndryshime të mëdha gjatë vitit 2018, megjithëse përmirësime të vogla u vunë re në dimensionet e advokimit dhe të qëndrueshmërisë financiare.

Për më shumë informacion: www.idmalbania.org



AMSHC mbështet nismën #ShqipëriaSolidare për situatën e krijuar nga goditja e tërmetit

Nëntor – Dhjetor 2019



e-albania.al/dhuro
e-albania.al/donate

Menjëherë pas goditjes nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, Qeveria Shqiptare inicioi nismën “**Shqipëria Solidare**”, ku nëpërmjet një adrese të vetme online www.e-albania.al çdo shqiptar mund të kontribuojë në lehtësimin e pasojave të tërmetit shkatërrues. Të gjitha kontributet e ndihmat do të adresohen nga struktura e posaçme shtetërore e Emergjencës Civile, për të lehtësuar dhe mbështetur qytetarët dhe familjet e prekura nga kjo fatkeqësi natyrore madhore.



Dhuro online
në e-albania

Kontribuo në
llogaritë bankare

Kontribut
tjetër



“Kontribute vullnetare, Emergjencia”

Numrat e llogarive në bankat e nivelit të dytë

Banka Credins

IBAN ne ALL (Lek): AL29 2121 1016 0000 0000 0030 0001
IBAN ne EUR : AL72 2121 1016 0000 0000 0030 0003
IBAN ne USD: AL02 2121 1016 0000 0000 0030 0002
SWIFT: CDISALTR

Banka Raiffeisen

IBAN ne ALL (Lek): AL38 2021 1013 0000 0000 0015 7945
IBAN ne EUR : AL85 2021 1013 0000 0000 0115 7945
IBAN ne USD: AL35 2021 1013 0000 0000 0215 7945
SWIFT: SGSBALTX

Banka ProCredit

IBAN ne ALL (Lek): AL92209110810000108613500001
IBAN ne EUR : AL81209110810000108613500102
IBAN ne USD: AL70209110810000108613500203
SWIFT: FEFAALTR

Banka Kombetare Tregtare

IBAN ne ALL (Lek): AL44 2051 1014 3288 86CL TJCL ALLA
IBAN ne EUR : AL11 2051 1014 3288 86CL TJCF EURA
IBAN ne USD: AL55 2051 1014 3288 86CL TJCF USDA
SWIFT: NCBAALTX

Tirana Bank

IBAN ne ALL (Lek): AL47 2061 1183 0000 0108 2000 0011
IBAN ne EUR : AL20 2061 1183 0000 0108 2000 0012
IBAN ne USD: AL74 2061 1183 0000 0108 2000 0010
SWIFT: TIRBALTR

Intesa SanPaolo

IBAN ne ALL (Lek): AL37 2081 1008 0000 0020 2453 0701
IBAN ne EUR : AL10 2081 1008 0000 0020 2453 0702
IBAN ne USD: AL80 2081 1008 0000 0020 2453 0703
SWIFT: USAALALTR

Union Bank

IBAN ne ALL (Lek): AL50 2141 1209 0111 1009 2516 0413
IBAN ne EUR : AL40 2141 1209 0111 1009 2525 0221
IBAN ne USD: AL66 2141 1209 0111 1009 2525 0141
SWIFT: UNALALTR

OTP

IBAN ne ALL (Lek): AL86 2131 1013 0000 0000 0084 1534
IBAN ne EUR : AL32 2131 1013 0000 0000 0084 1536
IBAN ne USD: AL05 2131 1013 0000 0000 0084 1537
SWIFT: PUPPALTR

Banka Amerikane e Investimeve

IBAN ne ALL (Lek): AL38 2101 1012 0000 0000 0003 8968
IBAN ne EUR : AL21 2101 1012 0000 0000 0007 1963
IBAN ne USD: AL38 2101 1012 0000 0000 0004 8280
SWIFT: EMPOALTR

Banka e Bashkuar e Shqiperise (UBA)

IBAN ne ALL (Lek): AL60 2031 1003 2010 1520 1101 0928
IBAN ne EUR : AL71 2031 1003 2010 1490 1101 0929
IBAN ne USD: AL88 2031 1003 2010 1400 1101 0929
SWIFT: AAISALTR

Banka Alpha

IBAN ne ALL (Lek): AL219021 1364 0191 2500 0067 1917
IBAN ne EUR : AL889021 1364 0191 2500 0067 0905
IBAN ne USD: AL789021 1364 0191 2500 0067 2928
SWIFT: CRBAALTR

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) në kuadër të menaxhimit të gjendjes së jashtëzakoshme që ndodhi në vendin tonë për shkak të situatës së tërmetit, përveç solidarizimit ftoi edhe vullnetarë të profilit të psikologjisë t'i bashkohen nismës **#ShqipëriaSolidare** për orientimin dhe këshillimin e prindërve në familje në rast tërmeti.

Në solidaritet dhe përgjigje të kësaj nisme, në fillim të muajit Dhjetor 2019, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) publikoi një përmbledhje me titull **“Këshilla për Prindërit në Familje në Rast Tërmeti”** të pyetjeve dhe përgjigjeve nga disa vullnetarë dhe ekspertë të profilit të psikologjisë, si më poshtë:

KËSHILLA PËR PRINDËRIT NË FAMILJE NË RAST TËRMETI

Publikuar: 7 dhjetor 2019

1. Ç'duhet të bëjmë në rast tërmeti?

(Elona Hasko, Eksperte për çështje të fëmijëve/Psikanaliste)

- Specialistët e inxhinierisë, sizmiologjisë, ndërtimit, etj, na sugjerojnë gjithmonë, që gjatë kohës që bie tërmet, duhet të ruajmë qetësinë, të mos lëvizim nga vendi ku jemi ose nëse mundemi të vendosim menjëherë poshtë tavolinave, krevatit apo pjesëve të qëndrueshme të shtëpisë, zyrës, ambientit ku ndodhemi.
- Kur të përfundojnë lëkundjet, menjëherë sapo kuptojmë që tërmeti ka pushuar duhet të dalim nga ambienti ku jemi dhe të drejtohem në vende të hapura, larg shtëpive, pallateve, pemëve, objekteve të forta.
- Duhet të bëhet kujdes gjatë daljes nga banesa, zyra, ambienti ku jemi, të lëvizet me kujdes nëpër shkallë e të mos përdoret ashensori, si dhe të bëhet kujdes që askush, sidomos fëmijët të mos vriten gjatë daljes nga banesa.

2. A duhet të tregojmë të vërtetën rreth tërmetit?

(Elona Hasko, Eksperte për çështje të fëmijëve/Psikanaliste)

- Po, gjithmonë fëmijëve duhet t'u tregojmë të vërtetën, por me fjali të thjeshta, të përmbledhura dhe të kuptueshme për ta.
- Duhet t'u tregojmë se tërmetet janë dukuri natyrore, që ndodhin përtej vullnetit dhe kontrollit tonë, por ne mundemi të marrim masa që tërmetet të mos na dëmtojnë ose kur janë shumë të fortë të dëmtojnë sa më pak të jetë e mundur.
- Duke iu treguar të vërtetën nuk i lëmë fëmijët të drejtohen drejt burimeve të pavërteta, të pasigurta që mund të shtojnë më shumë panikun.
- Informacionet shkencore, nga burime të sigurta, mund të ndihmojnë që fëmijët të kuptojnë më mirë këtë fenomen natyror e të lehtësojnë ankthin që mund të kenë përjetuar.
- Mësuesit në shkolla mund të japin një ndihmë në drejtim të kuptimit të këtij fenomeni dhe masave që mund të merren për ta menaxhuar atë gjatë dhe pasi ndodh duke ndihmuar dhe prindërit, familjet, kësisoj të qartësojnë dhe lehtësojnë frikën, ankthin e fëmijëve.

3. Si mund t'ua shpjegojmë fëmijëve tërmetin 3-10 vjeç? (Albana Xhemali, Psikologe)

- Në rastin re ngjarjeve natyrore, të pashpjegueshme si tërmetet, fëmijët mund të përjetojnë regres si pasojë e gjëndjes së ankthit dhe stresit që shkakton situata. Ndryshe nga të rriturit fëmijët, veçanërisht ata më të vegjël se 5 vjeç, nuk arrijnë të kuptojnë situatën dhe gjithashtu e kanë të vështirë të shprehen në lidhje me përjetimet e tyre. Duhet t'u shpjegojmë fëmijëve që ngjarja që ndodhi është një dukuri natyrore duke i thënë vazhdimisht që tani ata janë më të sigurtë. Ndjenjat e fajit te fëmijët janë gjithashtu të pranishme. Duhet të jemi të vëmendshëm dhe të bëjmë kujdes nëse fëmija ndihet fajtor. Duhet t'u themi që ajo që ndodhi nuk u shkaktua prej tyre dhe gjithashtu t'i qëndrojmë afër dhe të përgjigjemi ndaj nevojave që fëmija ka. Fëmijët pyesin shumë rreth asaj që ndodhi, pse ndodhi, a janë më të sigurt tani, etj. Ata janë të paqartë rreth situatës, mund të thonë që janë mirë, nuk janë të friksuar etj. Por në vizatimet e tyre ata tregojnë se janë ende të tronditur.
- Në situata të zakonshme fëmijët ndihen të sigurt kur prindërit i kanë pranë. Por në një situatë ku ndodhin dukuri të pashpjegueshme, fëmijët ndodhen në një territor të pasigurtë dhe kërkojnë t'i japin shpjegim asaj çfarë ndodhi.
- Nëse i themi fëmijëve që gjithçka mbaroi, dhe mundohemi t'u shmangemi pyetjeve që ata bëjnë, ndoshta kjo është e gabuar, sepse mund të rriste ankthin e tyre. Por ne mund t'u themi fëmijëve atë që sugjerohet prej specialistëve teknikë dhe të inxhinierisë, si p.sh.: " Lëkundja më e madhe kaloi, mund të ketë tërmete të vogla, por ne tani jemi të sigurt". Është e rëndësishme t'iu tregojnë fëmijëve vazhdimisht se tashmë janë më të sigurt dhe gjithashtu që jemi pranë tyre. Një përqafim në këto raste do ishte diçka e mirë.
- Fëmijët më të rritur se 5 vjeç mund t'i pyesim (duke qënë se janë më të aftë për të formuluar fjali që shpjegojnë gjendjen e tyre emocionale) se si e përjetuan ata ngjarjen. Mund të pikturojmë së bashku me ta, sepse kjo gjë i ndihmon. Edhe nga përvoja e deritanishme kam vënë re se fëmijët të cilët kishin përjetuar tërmetin e tregonin qartë në vizatime përjetimin e tyre dhe gjithashtu ato treguan se si e perceptonin ngjarjen.

4. Si ta menaxhoj panikun e fëmijëve të mi dhe si të suportojmë ankthin (Elona Hasko, Eksperte për çështje të fëmijëve/Psikanaliste)

- Është e rëndësishme të flitet me fëmijët mbi frikën që ka shkaktuar tërmeti, kjo është mënyra më e mirë për të lehtësuar panikun dhe përballuar ankthin.
- Prindërit duhet t'iu thonë fëmijëve se është krejt normale të kemi frikë apo ankth pas një tërmeti, të ndjehemi të mërzitur, të trishtuar, etj.
- Të folurit, të diskutuarit, të hulumtuarit e informacionit apo artikujve nga burime serioze/shkencore mbi fenomenin e tërmetit nga prindërit dhe fëmijët së bashku mund të ndihmojë të kuptuarit e fenomenit, masat që merren për përballimin e tij, etj. Gjetja e informacioneve të sakta mund të ndihmojë fëmijët, sidomos të menaxhojnë ankthin, se pas një tërmeti të fortë pritet të ketë të tjerë, të lehtë por që nuk dëmtojnë.

- Prindërit duhet t'u komunikojnë fëmijëve se është normale të ndiejmë e të kuptojmë se tërmeti është një situatë që nuk mund ta parandalojmë apo ta kontrollojmë të ndodhi, por ne mund të marrim masa të kujdesemi për veten që ai të mos na dëmtojë fizikisht.
- Prindërit duhet t'iu japin kurajo fëmijëve, t'iu kërkojnë të bëjnë pak durim dhe t'iu komunikojnë se mund të kalojnë pak kohë derisa të ndjehemi mirë sërish.
- Prindërit duhet të të përfshihen më shumë me fëmijët në lojëra dhe në aktivitete argëtuese, të cilat ndihmojnë shkarkimin e frikës, zemërimit, stresit, angushtisë, etj.

5. Kë besojnë më shumë fëmijët: Gjyshërit apo prindërit?

(Oltjana Sadiku Shehaj, Mësuese dhe Elona Hasko, Eksperte për çështje të fëmijëve/Psikanaliste)

- Fëmijët e vegjël janë më të predispozuar të besojnë më shumë prindërit e tyre në gjithçka që u thuhet, duke marrë në konsideratë faktin që gjyshërit janë më shumë mbështetës të vendimeve të prindërve.
- Gjyshërit mund të jenë dhe kanë qënë ndihmë e madhe për fëmijët pas traumës së tërmetit, duke ndihmuar familjet me strehimin, përkuduesjen e fëmijëve. Gjithashtu, një pjesë e fëmijëve mund të jenë shumë të lidhur me gjyshërit e të kalojnë mjaft kohë me ta, e për rrjedhojë mund t'iu besojnë më shumë gjyshërve. Kjo është diçka e mirë dhe thjesht prindërit duhet të komunikojnë me gjyshërit se si ata do ua shpjegojnë nipërve/mbesave të tyre fenomenin e tërmetit, në mënyrë që sqarimet të ngjasojnë me njëri-tjetrin.
- Gjyshërit për nga natyra janë më të qetë në shpjegimin e situatave të rrezikut dhe kanë prirjen të zbusin rëndesën e ngjarjeve dhe janë më të matur në reagime, ndërsa prindërit duke patur përgjegjësi të drejtpërdrejtë për jetën e fëmijës se tij ka ngarkesë emocionale që pa dashur e tejçon te femija, prandaj ndihma dhe roli i tyre në përballimin e kësaj ngjarjeje mund të jetë edhe më e dobishëm.

6. A e përjetojnë njësoj tërmetin të rriturit dhe fëmijët?

(Albana Xhemali, Psikologe)

Nuk mendoj se fëmijët e përjetojnë njësoj tërmetin si të rriturit. I rrituri tashmë ka një përvojë dhe gjithashtu ka informacion në lidhje me situatën dhe dukuritë natyrore. Si të rritur kemi më shumë përgjegjësi dhe ankthi rritet kur na duhet të mendojmë për fëmijët dhe personat e tjerë përreth. Ndërkohë fëmijët kanë nevojë për siguri, dhe kjo siguri thyhet kur ndodhë një dukuri e tillë si tërmeti. Fëmijët shprehen më pak se të rriturit në lidhje me ngjarjen, mund të mos e kuptojnë dot një dukuri si tërmeti dhe tek fëmijët e vegjël ndjenjat e fajit mund të jenë të pranishme pasi mund të mendojnë se janë ata që kanë shkaktuar ngjarjen. Gjithashtu mund të ndodhë që fëmijët të marrin rolin e një të rrituri dhe të marrin vetë përgjegjësi që nuk u takojnë.

7. Si dhe sa ndikon mekanizmi i shpresës dhe rinisjes së jetës?

(Miranda Doksani, Psikoterapiste/Specialiste e shëndetit mendor)

- Shpresa është e rëndësishme për mirëqënien tonë mendore. Neuroshkencëtarët që merren me studimin se si ndikon shpresa në trurin e njeriut kanë dalë në përfundimin se një ndjenjë shprese e ndryshon trurin. Truri pompon kimikate kur provon ndjesinë

e shpresës. Këto kimikate mund të bllokojnë dhimbjen dhe të përshpejtojnë shërimin. Rezultati është se truri mund të kapërcejë pengesat dhe të rimëkëmbet. Shpresa sjell një gjendje më pozitive të kapërcimit të vështirësive, apo traumave. Shpresa strukturon jetën tonë në pritje të së ardhmes dhe ndikon në mënyrën se si ndihemi në të tashmen.

- Mënyra në të cilën një person shpresëdhënës përballon zhgënjimin ndryshon nga ata që nuk janë. Edhe nëse e tashmja është e pakëndshme, mendimi për një të nesërme pozitive ul ndjeshëm stresin, rrit besimin dhe zvogëlon ndikimin e ngjarjeve negative. Në trauma e fatkeqësi kolektive shpresa merr një rëndësi shumë të madhe në perballimin e situatës, uljen e efekteve negative të traumës dhe risjell te viktimat kuptimin e jetës.

8. Si duhet të sillemi me fëmijët? **(Albana Xhemali, Psikologe)**

- Duhet të jemi të kujdesshëm ndaj çdo përjetimi dhe emocioni që fëmijët shfaqin. Së pari duhet të kuptojmë çfarë di fëmija për atë që ndodhi dhe si e përjetoi ai tërmetin. Mund t'i pyesim fëmijët: Çfarë ndodhi? A e dini ju se çfarë është tërmeti? Çfarë po bëje ti në momentin që ndodhi ngjarja? Gjatë ditëve në terren disa fëmijë ishin në gjendje të më tregonin se çfarë bën ata dhe të afërmit e tyre në çastin kur ra tërmeti. Fëmijët tentojnë të tregojnë se nuk patën frikë, veçanërisht ata mbi moshën 5 vjeç. Në një situatë të tillë mund t'iu themi që të kesh frikë është normale, mund t'iu tregojmë se dhe ne të rriturit u frikësua. Por tani gjërat janë më të qeta dhe jemi më të sigurt.
- Evitoni ekspozimin ndaj TV dhe lajmeve të fëmijëve. Lajmet sigurisht na mbajnë të informuar por edhe mund të rrisin ankthin. Një pjesë e fëmijëve që kam takuar u shprehën me këto fjalë, "A i pe lajmet, si ishin shkatërruar ato shtëpitë, i pe?". Ndoshta na duket se fëmijët nuk kuptojnë, por përvoja na tregon se ata janë më të zgjuar dhe vigjilentë nga sa ne e mendojmë. Prandaj ajo çfarë mund të bëjmë është që t'i përfshijmë ata në aktivitete fizike si lojra me top, kërcim, t'i nxjerrim në parqe dhe mjedise të hapura.
- Të mundohemi që t'iu rikthejmë fëmijët në rutinën e përditshme, duke stabilizuar vaktet dhe duke i përfshirë ata në disa aktivitete që zhvillojnë para se të ndodhte tërmeti.

9. Mund ta trajtojmë si lojë këtë fenomen? **(Oltjana Sadiku Shehaj, Mësuese)**

- Në shoqërinë shqiptare jemi mësuar që shpesh, situatat e rënda apo fatkeqësitë e mëdha t'i anashkalojmë duke mos i përmendur fare, duke mos i folur fëmijës për atë çka ndodhi. Një formë për të kaluar situata të tilla është të flasësh për fenomenin me qetësi duke e trajtuar çështjen në mënyrë sa më të kuptueshme për fëmijën.
- Tërmeti si fenomen nuk mund të konsiderohet lojë, as për më të vegjlit, por nëpërmjet lojës i tregon fëmijës aftësinë për të ndërtuar dhe si mund të shmangim shkatërrimin e asaj që sapo ndërtuam, apo si mund të reagojnë fëmijët gjatë një situatë të tillë. Lojrat me formuese, puzzle apo çdo instrument tjetër që ndodhet pranë mund të ndihmojë fëmijën për të kuptuar se sa bukur është të ndërtosh gjëra të mëdha.

- Nëpërmjet lojës i demonstron fëmijës duke bërë prova praktike se çfarë reagimi mund të kemi në këto raste. P.sh. në kopshtet në Tiranë, në ditë të veçanta gjatë vitit akademik organizohen situata konkrete nga specialistë se si duhet të sillen fëmijët në raste emergjencash si: rënie zjarri, gjë që mund të shtrihet edhe më gjerë si stimulime në shkollë duke përfshirë se si duhet të sillemi gjatë dhe pas tërmeteve.

10.Sa siguri kemi për ripërsëritje?

Tërmete ndodhin çdo vit në të gjithë botën. Kjo dukuri natyrore shkakton frikë e panik në popullatë për faktin se mund të sjellë dëme të mëdha materiale apo humbje të banesave apo ndertesave, si dhe mund të jetë aq i dëmshëm sa mund të marrë jetë njerëzish. Përsa i përket tërmetit të 26 Nëntorit, sizmologë vendas e të huaj me fakte shkencore, por dhe me krahasime të tërmeteve të rënë ndër vite, sigurojnë se rreziku për një tërmet të ngjashëm nuk mund të ndodhë. Kjo për faktin se pasgoditjet që kanë shqetësuar vendin po vijnë në ulje si në frekuencë ashtu edhe në intensitet.

11.Si të kthejmë buzëqeshjen tek fëmijët? (Sonilda Barjamaj, Terapiste/Psikanaliste)

- Të kthesh buzëqeshjen tek fëmijët do të thotë t'u kthesh atyre përditshmërinë. Pasi të këtë kaluar rreziku fizik, fëmijëve duhet t'u shpjegohet me shumë delikatesë dhe me fjalë të kuptueshme për ta dukuria e tërmetit dhe të merren masa për frikën, ankthin dhe panikun, përjetime shumë të mundshme në raste të tilla është e rëndësishme që fëmijët t'i kthehen jetës normale. Ata duhet t'u kthehen rutinave të tyre të përditshme si p.sh të shkuarit në shkollë/kopsht, realizimi i vizitave tek familjarët apo shokët e tyre, ndjekja e sporteve të caktuara apo aktiviteteve të ndryshme që i argëtojnë ata. Së bashku me kthimin në përditshmëri do të vijnë edhe buzëqeshjet. Sigurisht, që siguria, shpjegimi i dukurisë natyrore, menaxhimi i gjendjeve emocionale dhe rikthimi në përditshmëri nuk duhen marrë si procese të ndara nga njëri-tjetri, por si procese që bashkëndodhin.
- Prindërit duhet të bëjnë shumë kujdes me menaxhimin e emocioneve të veta në raste të tilla, pasi ndjenjat e frikës dhe panikut që ata mund të përjetojnë dhe mënyra se si i shprehin, por dhe i transmetojnë ato tek fëmijët e tyre mund të rëndojë përjetimet emocionale të fëmijëve.
- Një pjesë e fëmijëve dhe prindërve arrijnë t'i menaxhojnë shumë mirë situata të tilla, por të tjerë mund të kenë nevojë për ndihmë nga specialistët. Sa më herët të kërkohet kjo ndihmë, aq më mirë do të jetë për fëmijën.

Gjithashtu çdo i interesuar për këshilla të mëtejshme, u ftua të kontaktojë AMShC-në në kutinë e mesazheve "inbox" të rrjetit social Facebook apo adresës e-mail të AMShC-së, ku do të njoftohet menjëherë për shqetësimin e tij.

TAKIME INFORMUESE

*mbi procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të rinj
të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile*

Nëntor – Dhjetor 2019

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) përgjatë muajve Nëntor – Dhjetor 2019 zhvilloi disa takime informuese dhe konsultimi mbi procesin e përzgjedhjes së katër anëtarëve të shoqërisë civile të KKShC-së me organizata të shoqërisë civile.

Vendet vakante të anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile në Këshill janë krijuar për shkak të përfundimit të mandateve 2-vjeçare, përkatësisht:

- **2 (dy) anëtarë**
Fusha e veprimit A. Demokratizimi, shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE;
- **1 (një) anëtar**
Fusha e veprimit B. Zhvillimi ekonomik, territorial dhe mjedisor;
- **1 (një) anëtar**
Fusha e veprimit C. Mirëqenia, shërbimet sociale, mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës.

Gjatë kësaj periudhe u realizuan takimet në Kukës dhe Berat, por për shkak të emergjencës së krijuar nga goditja e tërmetit të 26 nëntorit 2019, takimet e radhës u ndërprejnë deri në një njoftim tjetër.

Në takimet e zhvilluara, përfaqësuesit e AMShC-së dhe organizatave të shoqërisë civile diskutuan mbi kriteret për kandidatët, dokumentacionet mbështetëse dhe fazat e procesit për përzgjedhjen e kandidaturave për anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane (ISSH) prezanton studimin “Përshpejtim i zhvillimit dhe bashkëpunimit qytetar”

Tiranë, 17 dhjetor 2019



Përfaqësues të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në prezantimin e studimit “Përshpejtim i zhvillimit dhe bashkëpunimit qytetar”, të realizuar nga Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane (ISSH) me përkrahjen e USAID, në kuadër të projektit “Përmirësimi i politikave lokale të qeverisjes, nëpërmjet pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve”. Gjetjet e studimit i prezantoi Drejtori Ekzekutiv i Institutit z. Leart Kola, ndërsa qëndrimet e Ministrisë së Brendshme i prezantoi Zv.Ministrja znj. Romina Kuko, e cila iu përgjigj gjithashtu pyetjeve të pjesëmarrësve lidhur me decentralizimin dhe ndryshimet, që ka sjellë reforma administrativo-territoriale e vitit

2013 si dhe procesin e regjistrimit dhe sinjalizimit të adresave. Prezente në panel ishte edhe Nënkryetarja e Bashkisë Tiranë znj. Anuela Ristani, e cila iu përgjigj interesit të pjesëmarrësve, ndër të tjera edhe mbi çështjen e centralizimit të një pjese të funksioneve pranë bashkive. Kjo çështje ka bërë që disa procedura të kenë ende nevojë për përmirësim. Sugjerimi i propozuar ishte përpilimi nga ana e bashkisë i formularëve standarde për ankesa/kërkesa të ndryshme, për t’ia lehtësuar komunikimin qytetarëve me institucionin. Ky studim tenton të përmirësojë politikat lokale të qeverisjes, nëpërmjet pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve si dhe për t’iu shërbyer më mirë nevojave të qytetarëve, me fokus të veçantë grupet vulnerabël. Për realizimin e studimit një grup ekspertësh të fushave të ndryshme kanë bashkëpunuar për gjatë një viti duke marrë në analizë bashkitë: Tiranë, Lezhë, Peshkopi, Korçë dhe Sarandë.



AMSHC ➤ Ditar 24

Tetor – Nëntor – Dhjetor 2019

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adresa: Rruga "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 4 22 355 69

E-mail: info@amshc.gov.al Website: www.amshc.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Ditar

Janar – Shkurt – Mars 2020

Nr. 25

Datë: 22.4.2020

NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI:

Faqe

Qendra ALTERUM, tryezë e rrumbullakët mbi të drejtat e të miturve	2
Nis procesi i konsultimit publik online me OShC-të mbi përcaktimin e prioritetëve të Thirrjes nr. 13	3
Shpallet thirrja për propozim të kandidatëve për anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC).....	3
Java e Integritetit / Forumi Shoqërisë Civile Kundër Korrupsionit.....	5
Partnerët Shqipëri / Ceremonia e Çmimeve të Filantropisë 2019	7
Takime informuese dhe konsultime publike me Organizata të Shoqërisë Civile	9
AMSHC shpall Thirrjen 13 për projekt-propozime	10
Vetëkarantinë për shkak të COVID-19	12
Lançohet Platforma informuese WWW.CORONAVIRUS.AL.....	12

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adresa: Rruga "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 4 22 355 69

Website: www.amshc.gov.al E-mail: info@amshc.gov.al

Fuqizohemi së bashku...

Qendra ALTERUM, tryezë e rrumbullakët mbi të drejtat e të miturve

Tiranë, 18 janar 2020



Përfaqësuesi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Ferhat Aga, mori pjesë në tryezën e rrumbullakët **“Të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin dhe trajtimi i tyre në mënyrë të barabartë gjatë vazhdimit të procesit mësimor”** organizuar nga Qendra ALTERUM, në kuadër të projektit “Mbrotjtja dhe garantimi procedural i të drejtave dhe rishoqërimin, riintegrimin dhe rehabilitimin të të miturve / të rinjve në konflikt me ligjin”.

Projekti i mbështetur financiarisht nga AMShC dhe veçanërisht, aktiviteti i datës 18 janar 2020, fokusohet në ndarjen e gjetjeve të studimit dhe organizimit të një diskutimi lidhur me problematikat dhe rekomandimet e ndërmarra me qëllim përmirësimin e situatës së të miturve në konflikt me ligjin.

Të pranishëm të tjerë në event ishte znj. Valbona Treska – Presidente e Urdhrit të Psikologut, e cila mbajti edhe fjalë përshëndetëse duke inkurajuar të pranishmit lidhur me rritjen e sensibilizimit të tyre mbi të drejtat e të miturve në procesin gjyqësor.

Z. Klodjan Skenderaj – Asoc. Prof. Dr. – ekspert pranë Qendrës ALTERUM, ndau me të pranishmit pozitën procedurale të të miturit gjatë procesit penal sikurse znj. Arbesa Kurti – Msc. Av. – eksperte pranë Qendrës ndau gjetjet dhe të dhënat statistikore lidhur me nivelin e kriminalitetit të të miturve gjatë periudhës 2018 – 2019.

Nis procesi i konsultimit publik online me OShC-të mbi përcaktimin e prioriteteve të Thirrjes nr. 13

28 janar – 20 shkurt 2020

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadër të realizimit të misionit të saj dhe në funksion të ofrimit të asistencës financiare për organizatat e shoqërisë civile, nis procesin e konsultimit publik me palët e interesuara lidhur me përcaktimin e prioriteteve të Thirrjes së radhës. Në këtë kuadër, ftohen përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile të dërgojnë Sugjerimet / Komentet / Vërejtjet e tyre me qëllim për t'ju ardhur sa më në ndihmë organizatave dhe projekteve që synohen të arrihen.

Komentet dhe sugjerimet, mund t'i dërgoni nga data 28 janar – 20 shkurt 2020, me e-mail në adresën: info@amshc.gov.al ose në linkun: <http://www.amshc.gov.al/web/prioritetet.php>

Theksojmë se, një pjesë e posaçme e fondit do të kanalizohet në projekt-propozimet në funksion të prioritetit strategjik qeveritar në Luftën kundër Korrupsionit në vend.

Për këtë qëllim, AMShC-ja, në vijim do t'ju njoftojë për organizimin e takimeve konsultative në kuadër të përcaktimit dhe saktësimit të prioriteteve për shpallje.



Shpallet thirrja për propozim të kandidatëve për anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

3 shkurt – 3 mars 2020¹

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), shpall thirrjen për propozim të kandidatëve anëtarë të shoqërisë civile në KKShC, për 4 (katër) vendet vakante të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 2-vjeçare, përkatësisht:

- **2 (dy) anëtarë** për fushën e veprimit “A. Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE”
- **1 (një) anëtar** për fushën e veprimit “B. Zhvillimi ekonomiko-territorialo-mjedisor”
- **1 (një) anëtar** për fushën e veprimit “C. Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës”

Në këtë fazë, ftohen të gjitha organizatat e shoqërisë civile të paraqesin propozimet e tyre për kandidatët duke plotësuar “**FORMULARIN STANDARD TË APLIKIMIT**”² – Për propozimin e kandidatëve

¹ Në datë 04.03.2020 njoftohet zgjatja e afatit të aplikimit deri më datë 08.03.2020

² Mund ta shkarkoni online në linkun: <http://www.amshc.gov.al/kkshc/>

nga përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile në KKShC dhe ta dërgojnë me e-mail në adresën kkshc@amshc.gov.al, me referencë të saktë të subjektit: **“Propozim Kandidature për KKSHC”**.

Faza e procesit të Propozimit të Kandidatëve anëtarë të KKShC-së është e hapur **nga data 3 shkurt 2020 deri më 3 mars 2020**, kohë në të cilën paraqiten kandidaturat dhe dokumentacionet mbështetëse si nga ana e organizatave propozuese të kandidatëve, ashtu edhe nga ana e të kandiduarve. FORMULARI STANDARD I APLIKIMIT dhe gjithë dokumentet mbështetëse të poshtëshënuara duhet t'i dërgoni brenda afatit të përcaktuar, me rrugë elektronike në adresën kkshc@amshc.gov.al ose dorazi/me postë në adresën:

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC)
Rruga "Frosina Plaku", Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri

KRITERET PËR KANDIDATËT DHE DOKUMENTACIONET MBËSHTETËSE:

- 1. Dokumentet që duhen dorëzuar nga organizatat që nominojnë kandidatët:**
 - Formulari i Aplikimit, i publikuar nga AMSHC
 - Kopje e dokumentit të regjistrimit në Gjykatë
 - Konfirmim nga zyra e e tatimeve që organizata e ka statusin "aktiv"
- 2. Kriteret që duhen përmbushur nga kandidatët për KKSHC:**
 - Të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë në rol drejtues në organizata të shoqërisë civile në fushën ku kandidon
 - Të mos ketë role koordinuese ose drejtuese në organizata politike ose parti politike
- 3. Dokumentet që duhen dorëzuar nga të nominuarit:**
 - Jetëshkrimi (CV – Curriculum Vitae);
 - Letër motivimi nga kandidati për të shpjeguar kontributin që mund të japë pranë KKSHC-së
 - Letër konfirmuese nga organizata e shoqërisë civile se kandidati ka të paktën 3 (tre) vite eksperiencë në fushën ku kandidon;
 - Pesë letra mbështetëse nga organizata të tjera të cilat mbështesin kandidatin

NOMINIMET DHE PROCEDURA E VOTIMIT:

- Të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile të regjistruara dhe aktive, nominojnë kandidatët e tyre duke pasur parasysh se çdo subjekt **mund të emërojë vetëm një kandidat për anëtar të KKSHC-së**.
- Aplikantëve ju lejohet **një mundësi për të apeluar brenda 3 (tre) ditësh** pas publikimit të listës së nominimeve të vlefshme, në rast se nominimet e tyre janë konsideruar të pavlefshme.
- Komisioni Teknik i AMShC-së pranë KKShC-së publikon në faqen e internetit **Thirrje Publike për Votimin** për kandidatët e vlefshëm. Subjektet votojnë për kandidatët nga lista e kandidatëve të përpiluar nga Komisioni Teknik i AMShC-së **duke respektuar parimin që një organizatë mund të votojë vetëm një herë kandidatin e preferuar për secilën për fushë**.
- Komisioni Teknik i AMShC-së vijon më tej me numërimin e votave (në një seancë të hapur dhe transparente) dhe kandidatët me numrin më të madh të votave të vlefshme, shpallen automatikisht si anëtarë të KKSHC-së

Për më shumë informacione vizitoni faqen www.amshc.gov.al/kkshc, ndërsa për pyetje ju lutemi na shkruani në adresën kkshc@amshc.gov.al.

Java e Integritetit / Forumi Shoqërisë Civile Kundër Korrupsionit

Tiranë, 5 shkurt 2020



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në **“Forum e Shoqërisë Civile Kundër Korrupsionit”**, të organizuar nga Ministrija e Drejtësisë, njëherazi dhe Koordinatore Kombëtare Kundër Korrupsionit, i cili u mbajt në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë.

Në fjalën e saj të hapjes, znj. Gjonaj prezantoi draftin e ri të Strategjisë Kundër Korrupsionit për periudhën 2020-2023, ku përfshihet lufta ndaj korrupsionit në administratën publike dhe do të fokusohet te qasja parandaluese, qasja represive e ndëshkuese dhe ajo ndërgjegjësuese.


Përfaqësuesi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Aga prezantoi

shkurtimisht rolin që AMShC-së ka në mbështetjen e nismave të shoqërisë civile në projektet që ndërmarrin në kuadër të antikorrupsionit, transparencës, llogaridhënies dhe integritetit.

Të ftuar të tjerë në forum, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile si dhe ekspertë kundër korrupsionit prezantuan projekte të ndryshme në luftën kundër korrupsionit, pro integritetit, llogaridhënies dhe transparencës.

Ky forum organizohet në kuadër të “Javës së Integritetit”, nismë e cila mundësohet në bashkëpunim me Dhomën Ndërkombëtare të Tregtisë në Shqipëri si dhe mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe Ambasadës Hollandeze në Shqipëri.





Partnerët Shqipëri / Ceremonia e Çmimeve të Filantropisë 2019

Tiranë, 7 shkurt 2020



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në ceremoninë e shpalljes së fituesit të konkursit “Çmimi i Filantropisë 2019”, të organizuar nga Partnerët Shqipëri, e cila u mbajt në ambientet e Hotel Rogner.



Çmimi është mirënjohje ndaj individëve dhe kompanive aktive në mbështetje të kauzave sociale në Shqipëri gjatë vitit 2019.

Pjesëmarrës në ceremoni ishin edhe personalitete nga qeveria shqiptare, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, trupi diplomatik i akredituar në Shqipëri, institucione ndërkombëtare dhe agjenci donatore, përfaqësues të sektorit të biznesit, atij jofitimprurës dhe medias.

Çmimi për Kontributin në Nivel Kombëtar, iu akordua SIGAL UNIQA Group AUSTRIA me motivacion: Për angazhim dhe kontribut të gjerë në shëndetësi, arsim, mjedis, art, sport dhe edukim financiar në fushën e sigurimeve, ku veçohen: Klinika Lëvizëse Mjekësore në shkallë vendi, rikonstrukcioni i Shkollës së Mesme të Bashkuar “Matosh UKA” në Fierzë, Tropojë dhe Pallatit të Sportit Përmet, si dhe krijimi i Klubit “Art dhe Kulturë” në dispozicion për të gjithë qytetarët e Durrësit”. Çmimi iu dha z. Avni Ponari,




Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria, nga znj. Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë.

Çmimi për Kontributin në Nivel Lokal iu akordua Kompanisë Mrizi i Zanave, me motivacion: Për kontributin e dhënë në promovimin dhe zhvillimin e vlerave tradicionale të zonës së Fishtës, Lezhë, duke e kthyer atë në një atraksion turistik dhe destinacion kulinar të mbështetur fort në zhvillimin e ekonomisë familjare dhe punësimin e



banorëve të zonës. Çmimi iu dha z. Anton Prenga dhe z. Altin Prenga nga z. Silvio Pedrazzi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank Albania.

Çmimi për Kontributin si Individ iu akordua Zj. Suela Bala, me motivacion: Për iniciativën e organizimit të “Bibliotekës Lëvizëse”, si një platformë edukuese dhe një dritare integruese për fëmijët dhe të rinjtë nëpërmjet librit në bashkinë e Lezhës, duke krijuar një model të suksesshëm që u shndërrua në një lëvizje gjithëpërfshirëse në të gjithë vendin. Çmimi u dorëzua nga Sh.T. Z. Luigi



Soreca, Ambasador i Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Çmimi Pionieri i Filantropisë iu akordua z. Hamza Rama (pas vdekjes), me motivacion: Për ndihmën bujare dhe kontributin e çmuar në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e kushteve shëndetësore të qytetarëve dhe familjeve në nevojë në qytetin e Lezhës dhe fshatrat përreth, si dhe për mbështetjen financiare të klubit sportiv “Bardhyli”, të Lezhës. Çmimi u dorëzua nga znj. Mira Rakacolli, Zv. Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.



Çmimi u tërhoq nga z. Irfan Rama, i biri i z. Hamza Rama.

Çmimi i Mirënjohjes për Angazhim Qytetar iu akordua zj. Delina Fico, nga zj. Marinela Jazoj, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës së Investitorëve të



Huaj në Shqipëri dhe Konsulle Nderi e Norvegjisë, me motivacion: Për kontributin e çmuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kauzave të ndryshme sociale në vend, veçanërisht për mbrojtjen e të drejtave të grave e vajzave dhe promovimin e barazisë gjinore në shoqërinë shqiptare.

Çmim Special iu akordua z. Arben Cara me motivacion: Për kryerjen me heroizëm dhe devotshmëri maksimale të detyrës së zjarrëfikësit në përpjekjet e kërkim-shpëtimit të jetëve të prekura nga tragjedia e tërmetit të 26 nëntorit 2019, duke vënë në plan të parë misionin e profesionit edhe në kushtet më ekstreme të rrethanave personale.”



Çmim Special iu akordua Komunës së Prizrenit, z. Mytahir Haskuka, Kryetar i Komunës së Prizrenit me motivacion: Për ndihmën bujare dhe të pakushtëzuar në pritjen dhe strehimin e



qytetarëve shqiptarë të dëmtuar nga tragjedia e tërmetit të 26 nëntorit 2019, pjesë e mbështetjes

dhe solidaritetit të jashtëzakonshëm të popullit dhe institucioneve të Kosovës.

Çmimet Speciale u dorëzuan nga z. Petro Koçi, Zv. Ministër i Mbrojtjes.


Kjo ceremoni ishte planifikuar të zhvillohej në datën 26 nëntor 2019, por për shkak të goditjes së tërmetit u zhvillua më datë 7 shkurt 2020.



Takime informuese dhe konsultime publike me OShC-të

31 Janar – 20 shkurt 2020

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadër të realizimit të misionit të saj dhe në funksion të ofrimit të asistencës financiare për Organizatat e Shoqërisë Civile organizoi në disa qytete të vendit takime informuese dhe konsultimi publik me përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile:



1. Mbi procesin e përzgjedhjes së katër anëtarëve të rinj të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile
2. Mbi procesin e përcaktimit të prioriteteve të Thirrjes nr. 13 për Projekt-Propozime

Për Organizatat e Shoqërisë Civile u krijua gjithashtu mundësia e dërgimit online e komenteve dhe sugjerimeve mbi prioritetet e Thirrjes nr. 13 me e-mail ose në faqen zyrtare www.amshc.gov.al, nga data 28 janar – 20 shkurt 2020.

Takimet u zhvilluan në qytetet: **Vlorë, Korçë, Gjirokastër, Kukës, Berat, Shkodër dhe Tiranë.**

Në takimet e organizuara si dhe nga shqyrtimi i të gjitha materialeve të marra në rrugë elektronike dhe në formë të shkruar (hard copy), ku përfaqësuesit e OJF-ve dhe grupet e interesit listuan sugjerimet, janë përmbledhur disa prej tyre si më poshtë:

- *Dhënie e ndihmës për personat e vetmuar me fokus përballimi i dëmeve të tërmetit të 26 Nëntorit 2019 nga të mbijetuarit kryesisht kryefamiljareve dhe fëmijëve;*
- *Lufta kundër korrupsionit;*
- *E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjve në qeverisje, transparencë e institucioneve publike;*
- *Shëndetësia nëpërmjet implementimit të projekteve që ruajnë dhe japin informacione në lidhje me shëndetin fizik dhe mendor, duke u fokusuar tek gratë dhe të rinjtë;*
- *Nxitja, stimulimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit;*
- *Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmbytjet, zjarret, tërmete etj.);*
- *Promovimi dhe ruajtja e vlerave historike, etnografike, turistike, artistike, kulturore, guidat turistike, koleksionistët, tolerancës fetare etj. si vlera historike e kombit shqiptar dhe detyrim ndaj brezave të ardhshëm;*
- *Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj.;*
- *Mirëqeverisja (Pushteti Qendror dhe Lokal), transparenca, llogaridhënia, lufta kundër korrupsionit, përgjegjshmëria dhe integriteti, reforma në drejtësi, rritje kapacitetesh, inovacion, monitorim, partneritet etj.;*
- *Edukim qytetar në funksion të proceseve integruese (familja, shkolla, komuniteti, biznesi, institucionet shtetërore etj.)*

AMSHC shpall Thirrjen 13 për projekt-propozime

2 mars – 10 prill 2020

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) shpall Thirrjen Nr. 13 për Shprehje Interesi dhe fton OJF-të e interesuara të sjellin projekt-propozime që kanë si objekt dhe mbulojnë fushën prioritare:



1. Zhvillimi Social dhe Shërbimet Sociale:

- *Ritja e kapaciteteve të grupeve, organizatave që kanë si mision të tyre shërbimet sociale;*
- *Dhënie e ndihmës për personat e vetmuar me fokus përballimi i dëmeve të tërmetit të 26 Nëntorit 2019 nga të mbijetuarit kryesisht kryefamiljareve dhe fëmijëve;*
- *Ritja e kujdesit për shtresat vunerabël e ato në nevojë si dhe çështjet e përfaqësimit të minoriteteve (rome, egjiptjan, LGBT, etj);*
- *Nxitja, stimulimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit;*
- *Shëndetësia nëpërmjet implementimit të projekteve që ruajnë dhe japin informacione në lidhje me shëndetin fizik dhe mendor, duke u fokusuar tek gratë dhe të rinjtë*

2. Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut:

- Në fushën e Prokurimeve;
- Në fushën e Arsimit;
- Në fushën e Shëndetësisë dhe
- Zbatimit të Ligjit;
- E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjve në qeverisje, transparencë e institucioneve publike

3. Mjedis, Turizmi dhe Zhvillimi i qëndrueshëm:

- Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmytjet, zjarret, tërmete etj.);
- Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe konkurrues i zhvillimit të qëndrueshëm
- Promovimi dhe ruajtja e vlerave historike, etnografike, turistike, artistike, kulturore, guidat turistike, koleksionistët, tolerancës fetare etj. si vlera historike e kombit shqiptar dhe detyrim ndaj brezave të ardhshëm
- Trajnime për mjeshtëri tradicionale që janë në rrezik zhdukjeje (zejtaria, mjeshtër restaurator të shtëpive karakteristike etj.)

4. Integrimi – Shoqëria civile si faktor, aktor dhe partner i rëndësishëm në proceset e integritit evropian dhe rajonal të vendit:

- Sensibilizim, fuqizim kapacitetesh për një mjedis mundësues në proceset integruese;
- Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj.;
- Mirëqeverisja (Pushteti Qendror dhe Lokal), transparencë, llogaridhënia, lufta kundër korrupsionit, përgjegjshmëria dhe integriteti, reforma në drejtësi, rritje kapacitetesh, inovacion, monitorim, partneritet etj.;
- Të shihet si prioritet fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;
- Edukim qytetar në funksion të proceseve integruese (familja, shkolla, komuniteti, biznesi, institucionet shtetërore etj.)

NJOFTIM**për pezullimin e Thirrjes 13**

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në kuadër të masave kundër përhapjes së virusit COVID-19 njofton:

Pezullimin e afatit të aplikimit të organizatave të shoqërisë civile për mbështetje financiare nëpërmjet Thirrjes nr. 13 prej datës 17.03.2020 deri në një njoftim të dytë. Aplikimet e marra me rrugë postare përgjatë kësaj periudhe do të shqyrtohen me mbarimin e afatit të pezullimit.

Për më shumë informacion, vizitoni faqen zyrtare:

www.amshc.gov.al

VETËKARANTINA
COVID-19

Vetëkarantinë për shkak të COVID-19


12 mars 2020

Personat që mund të kenë qenë të ekspozuar ndaj individëve të dyshuar për COVID-19, duhet që të vetëkarantinohen dhe të monitorojnë shëndetin e tyre për 14 ditë, që nga dita e fundit me kontaktin e mundshëm. Të kërkojnë mbikëqyrje të menjëhershme mjekësore, nëse paraqesin ndonjë nga simptomat, veçanërisht temperaturë, simptoma respiratore si kollë dhe vështirësi në frymëmarrje apo diarre, menjëherë të kontaktojnë 127. Të gjithë qytetarët rekomandohet që të shmangin daljet në publik dhe të qëndrojnë në shtëpi duke respektuar rregullat e higjenes.

Lançohet platforma informuese

WWW.CORONAVIRUS.AL

27 mars 2020



Platforma online "CORONAVIRUS ALBANIA" ofron në kohë reale rregulla e këshilla, statistika dhe pasqyrimin e të rejeve të fundit mbi gjendjen e shkaktuar nga COVID-19 në Shqipëri. Gjithashtu në këtë platform gjendet informacion mbi masat parandaluese, aktet ligjore dhe pasojat e kundravajtjeve, masat financiare etj.

Ditar Nr. 25

Janar – Shkurt – Mars 2020

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adresa: Rruga "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 4 22 355 69

Website: www.amshc.gov.al E-mail: info@amshc.gov.al